



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova – RepublicofKosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 24.5.2024, e cila filloj në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina ( i pavarur), kryesues i Kuvendit, Tria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Arbër Limani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fikneta Bejtë (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

**Munguan:** Berat Lahu (LVV), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Arbnora Ajeti (PDK), Amir Simnica (LDK) dhe Sami Boroci (AKR).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkyetar, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donjeta Dragusha, drejtore e Zhvillimit Rural, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Arber Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të banorëve të lagjes "Kalabria" dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

**Arbër Sadiki**, drejtor, tha se sa i përket Planit rregullues të lagjes "Kalabria", propozoj që të caktohet një datë për një sencë të Kuvendit, ku do të diskutohet vetëm kjo pikë e rendit të ditës.

**Gëzim Sveçla** theksoi se në momentin kur ky plan na dërgohet neve, atëhere ekzekutivi në afatin brenda tre ditëve mund ta thirrë një mbledhje të jashtëzakonshme për shqyrtimin e tijë. Si LVV e përkrahim dhe e mbështesim planin për lagjen "Kalabria", i cili plan duhet të jetë në mënyrë profesionale, që merr parasysh kërkeshat e banorëve të lagjes "Kalabria", pa e favorizuar asnje grup të caktuar dhe pa rënë ndesh me ligjin në asnje pikë të tijë.

**Gëzim Mehmeti** kërkoi nga ekzekutivi që sot të publikohet Plani rregullues i lagjes "Kalabria", ku do të ketë qasje qytetari, mediet dhe asamblistët.

**Leutrim Retkoceri**, sa i pëket Planit rregullues të lagjes "Kalabria", kërkoi të dij arsyetimin e mos publikimit të tij. Lidhur me këtë, tha se jemi për me kaluar plane të mirëfillta që respektojnë ligjin, që respektojnë banorin e asaj lagje dhe në fund që ai plan kur kalon të mos dështoj dhe të mos e kthej prapë Ministria, ashtu si e ka kthyer Planin e vitit 2021. Ne si asamblist kemi nevojë me e pa këtë plan.

**Bahri Gashi** kërkoi nga kryetari që mundësishët të mbahet një seancë e jashtëzakonshme brenda 10 ditëve dhe që sot të na dërgohet materiali për Planin rregullues të lagjes "Kalabria", me e trajtuar këtë material, në mënyrë që të dijmë se kujt iu ka pranuar kërkesa e kujt jo dhe mos të bëjmë politikë në kurrit të këtyre banorëve që janë prezent këtu në sallë.

**Faton Zeka**, si banor i lagjes "Kalabria", tha se "Kalabria" nuk është vetëm e imja, po e të gjithë atyre banorëve që jetojnë aty dhe është përgjegjësi e secilit prej nesh qe jemi këtu, ta trajtojmë këtë çështje në mënyrën sa më serioze. Ai kërkoi që të caktohet një seancë e jashtëzakonshme që të trajtohet plani rregulluesi kësaj lagjeje.

**Përparim Rama**, kryetar, the se i gjith dokumentacioni i Planit rregullues të lagjes "Kalabria" është i gatshëm për publikim dhe që në javën e ardhshme do ta mbajmë një seancë të jashtëzakonshme dhe do ta shqyrtojmë në hollësi këtë plan.

Kryetari po ashtu propozoi që pika e katërt e rendit të ditës të ndryshohet dhe të jetë: Propozim-vendimi për paradhënie lidhur më shpërblimin e dëmit, në shumën prej 110 mijë euro, për znj. Elza Ujkani.

**Granit Geci** tha se është më se dëshpëruese se si po abuzohet me qytetarët e lagjes "Kalabria", andaj do të ishte më se e domosdoshme që ky plan të trajtohet në mënyrën sa më serioze dhe tu bëhet një zgjidhje atyre banorëve të cilët deri më tanë nuk kanë mundur ta realizojnë të drejtën e vetë për ndërtim.

**Gëzim Mehmeti**, kërkoi po ashtu që të bëhet publikim i këtij plani rregullues, pastaj të caktohet një seancë e jashtëzakonshme që të bëhet shqyrtimi i tij.

**Leutrim Retkoceri**, kërkoi nga kryetari, që sa më shpejtë të bëhet publikimi i Planit rregullues të lagjes "Kalabria", si dhe mundësishët të caktohet një seancë për shqyrtimin e

tij, me qëllim që këtë plan ta shohin edhe qytetarët e kësaj lagjeje, ta shohin edhe asamblistët se çfar përmban ai plan në brendi dhe për far do të votojnë.

**Milot Krasniqi**, qytetar, tha se neve qytetarëve të kësaj lagjeje na është bërë e padrejtë, na është anuluar një plan, na është anuluar e drejta jonë për me u zhvilluar koeficienti 2.4, kështu që kërkojmë që sa më shpejtë të votohet ky plan, me ndryshimet dhe kërkesat të cilat i kemi dhënë, një plan që iu konvenon të gjithë banorëve të lagjës "Kalabria".

**Bahri Sejdiu**, banor i fshatit Shkabaj, njëherësh edhe imam në Xhaminë e Madhe të Prishtinës, kërkoi nga kryetari shpronësimin e një prone prej 3300 ari që është në mes të fshatit, ku gjendet objekti i shkollës, zyra e Bashkësisë lokale dhe parku, me qëllimin të ndarjes së një parcele për ndërtimin e një xhamie në këtë lokalitet.

**Hafiz Krasniqi** tha se duke pasur parasysh diskutimet për disa fusha të ndryshme, propozoj që të zbatohet Rregullorja e punës së Kuvendit, së pari të procedojmë me rendin e ditës, pastaj çëshjet e qytetareve dhe pyetjet dhe përgjigjet që janë kryekëput të lidhura për qytetarë, ti lëmë në fund, kështu që të ketë mbarëvajtje seanca.

**Gëzim Mehmeti** tha se sa i përket propozimit të kryetarit për shpërblimin e dëmit për znj. Elza Ujkani, e lënduar, pavarësisht tragedisë që ka ndodhure me vajzën, konsideroi se jemi duke bërë një precedent, kështu që shprehem publikisht që: "Unë personalisht në këtë mënyrë jam kundër dhe do të votoj kundër këtij propozim-vendimi".

**Endrit Zabërgja** tha se duke i pasur për bazë diskutimet lidhur me Planin rregullues të lagjes "Kalabria", propozimin e kryetarir Rama, si dhe kërkesat e banorëve, propozoi të caktohet një seancë e jashtëzakonshme, që të bëhet shqyrtimi i këtij plani rregullues.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Doruntinë Maloku, drejtore.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e kryetarit për ndryshimin e pikës së katërt.

**Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 2 vota kundër, u miratua propozimi i kryetarit për ndryshimin e pikës së katërt të rendit të ditës.**

**Me ndryshimin e rendit të ditës, kryesuesi konstatoi se më 37 vota për, u miratua ky**

#### Rendi i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes se parë të Kuvendi të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për vënien në konsultim publikë të Projektrregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;
3. Diskutimi lidhur me aktivitetet e prokurimit: Titulli i kontratës i dhënë nga autoritetet kontraktuese: 119 programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës (SIPA UA 06.2021);
4. Propozim-vendimi për paradhënie lidhur më shpërblimin e dëmit të znj. Elza Ujkani, në shumë prej 110 mijë euro;

Faqe3ngal1

5. Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike "Prishtina Parking ", SHA;
6. Pyetje dhe përgjigje;
7. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendi të Kryeqytetit.

**Muhamed Selmani**, bëri një sqarim reth pikës së tetë të rendit të ditës, për Propozim-vendimin për vazhdimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës sociale edukative "Don Bosko", i cili tha se, unë kamë votuar për, kurse znj. Gresa Lahu ka abstenuar, dhe për arsy që i kemi ndërruar vendet është ndërruar edhe vota, andaj kërkoj që ky votim të përmirësohet.

**Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 1 abstenime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendi të Kryeqytetit.**

#### Pika e dytë

**Propozim-vendimi për vënien në konsultim publik të Projekt- rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës.**

Lidhur me këtë propozim-vendim për vënien në konsultim publik për Projektrregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kyretar.

**Nora Kelmendi** tha se ne si GP i LVV-së, do t'i dërgojmë të gjitha komentet dhe sugjerimet gjatë procesit të diskutimeve, në mënyrë që pastaj të inkorporohen në tekstin final.

**Pëllumb Bajqinovci** tha se, pasi që kemi diskutimin publik, inkurajoj të gjitha grupet që ato vërejtje dhe sugjerime që kanë t'i dërgojnë te komisioni për shqyrtim. Si GP i LDK-së e përkrahim këtë propozim-vendim që të dalë në diskutim publik.

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket kësaj rregulloreje, mendoj se kjo rregullore lë hapsirë shumë për t'u diskutuar për kritere, pasi që disa komisione janë në përbërje të cekët prej 3 anëtareve dhe mungon pjesa e përfaqësuesve nga Shoqëria civile. Po ashtu, kjo rregullore mundëson që paratë e taksapaguesve të Prishtinës të ju jepen edhe banorëve që nuk janë banorë të komunës se Prishtinës, e kjo bie ndeshë me Ligjin për financa publike, ku taksapaguesit e Prishtinës, ose paratë e buxhetit të Prishtinës duhet të dedikohen për qytetarët apo banorët e Kryeqytetit.

**Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për dhe 7 vota kundër, u miratua Vendimi për vënien në konsultim publik të Projektrregullores për ndarjen e subvacioneve nga Komuna e Prishtinës.**

### **Pika e tretë**

**Diskutim lidhur me aktivitetet e prokurimit: Titulli i kontratës i dhënë nga autoritetet kontraktues: 119 programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në komunën e Prishtinës (SIPA UA 06.2021).**

**Gëzim Mehmeti** tha se ky projekt është thelbësor për përmirësimin e infrastrukturës së ndriçimit publik, rritjen e sigurisë dhe efikasitetin energetik në Prishtinë. Në këtë kontest, dua të adresoj disa shqetësimë të bazuara në fakte e të cilat duhet vërtetuar edhe nga ana e ekzekutivit. Nga parimet bazë të prokurimit publik është se, që çdo kompani të këtë mundësin e barabartë për të konkuruar, çdo devijim nga ky parim jo vetëm që dëmton integritetin e procesit, por minon besimin e qytetarëve në institucionet tona dhe dëmton klimën e biznesit në vendin tonë, pasi që me këtë kontratë favorizohet një vend, i cili nuk është miqësor me Kosovën, kështu që ne nuk guxojmë të varemi nga një teknologji e një vendi jo miqësor. Duke pasur për bazë dyshimet lidhur me këtë kontratë, kërkoj nga kryetari që të anulohet ky proces.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga z. Mehmeti, Përparim Rama, kryetar, dha sqarime të nevojshme.

**Arbër Limani** tha se po t'i referohemi këtij aktiviteti të prokurimit lidhur me këtë kontratë, shohim se nuk ka transparencë të shprehur, e mbi të gjitha nuk korrespondon me një aktivitet prokurimi real, sepse edhe në përpilimin e përmasave kemi shumë pozicione të cilat nuk arsytohen dhe kemi shumë të cilat janë të vendosura për të krijuar hutësi të operatorët ekonomikë, që në mënyrë direkte të krijohen mostransparencë. Grupi i asamblistëve të LVV-së kërkon direkt që të njoftohen qytetarët dhe gjithë stafin asamblistë se si lejohen procedurat të tilla të prokurorimit, duke orientuar e krijuar monopol mbi të gjitha, të njoftohen se cilat kanë qenë ekipet e ekspertëve që kanë punuar në specifikacionet teknike, raportet, evidentimet e punëve që duhet realizuar, projektet ideore e tjera.

**Jeta Rafuna** shprehu mendimin se ky është një projekt, i cili i duhet qytetit të Prishtinës dhe fshatrave të komunës së Prishtinës, të cilat janë në erësirë dhe shpresojmë që kjo gjendje sa më shpejt të ndryshojë dhe ne qëndrojmë prapa arsyetimit të kryetarit.

**Leutrim Retkoceri** tha se, sipas Ligjit të prokurorimit, 30 ditë para fillimit të çdo viti kalendarik dërgohet planifikimi paraprak në Zyrën e prokurorimit për projektet. Ky projekt është dërguar, por këtu kanë mbetur edhe disa procese, hallka tjera për t'u kompletuar derisa ka ardhur në thirrjen apo publikimin e këtij tenderimi. Lidhur me këtë proces, kërkoj që të gjitha këto dokumente të kësaj kontrate të bashkëngjiten dhe të dërgohen te asamblistët, në mënyrë që të trajtohet vërtetësia e kësaj, pra që të shohim se

kërkesa që është bërë për pajisje të caktuara a është e porositur, apo ka qenë rastësisht e përfshirë në këtë proces.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se në raste të tillë kur kemi dyshime, kjo duhet me u bërë si praktikë, që çështje të tillë që drejtpërdrejtë e prekin edhe buxhetin e qytetit, por edhe qytetarët në përgjithësi, të bëhen tema që diskutohen në këtë Kuvend, t'i trajtojmë këtu për shkak se jemi të thirrur që atëherë kur ndjehet i rrezikuar interes i qytetarëve në çfarëdo forme, financiare apo edhe më gjerë, të jemi ata që i sqarojmë dyshimet eventuale. Dyshimet tona janë se kriteret të cilat janë të kërkuar e ulin konkurrencën, ka mungesë transparence në këtë kontratë, prandaj në përpilimin e kritereve për çfarëdo kontrate, duhet pasur që këto kritere sa më shumë të largohen ose mos të i'u përshtaten pajisjeve që kanë prejardhjen nga ky vend që nuk është miqësor me neve.

#### Pika e katërt

**Propozim-vendimi për paradhënie lidhur me shpërblimin e dëmit në shumë prej 110 mijë euro për Elza Ujkani.**

Për këtë propozim-vendim, arsyeshmërinë për votimin e tij e paraqiti Përparim Rama, kryetar.

**Gëzim Sveçla** tha se, ne si GP i LVV-së, në një situatë të tillë e mbështesim dhe e përkrahim për miratim këtë propozim-vendim.

**Sami Salihu** tha se ne si GP i LDK-së e mbështesim plotësisht propozimin e kryetarit Rama për të ndihmuar financiarisht znj. Ujkani, e cila është përballur me pasojat e një aksidenti jo të lehtë në oborrin e objektit të ri të Komunës.

**Gresa Lahu** tha se ne si grup i PDK-së e përkrahim këtë ndihmë financiare, e cila do të shkojë tek znj. Elza Ujkani, e dëmtuar nga rënia e kulmit të objektit të ri të Komunës në janar të këtij viti. Lidhur me këtë lloj rreziku, banorët e lagjes "Ulpiana" kanë kërkuar mbikëqyrjen e një kulmi, sepse nga erërat e forta është vërejtur luhatje, lëvizje e madhe e një kulmi.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 36 vota për, u miratua Vendimi për paradhënie lidhur me shpërblimin e dëmit në shumë prej 110 mijë euro për znj. Elza Ujkani.**

#### Pika e pestë

**Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike të "Prishtina Parking", SHA.**

**Lindita Rexhepi**, në cilësinë e anëtares së komisionit komunal të ndërmarrjes publike "Prishtina Parking", SHA, para të pranishmëve në pika të shkurtra paraqiti një raport informues lidhur me punën e kësaj ndërmarrjeje.

**Fehim Osmani** tha se raporti i ndërmarrjes "Prishtina Parking", do të duhet ta kishte qëllim themelor njoftimin e Kuvendit për gjendjen në të cilën ndodhet ndërmarrja. Sukseset dhe problemet nëpër të cilat ka kaluar në vitin paraprak, respektivisht në vitin 2023. periudha për të cilin raportohet sot, e që më pastaj në bazë të gjendjes ekzistuese dhe diskutimeve të merren vërejtjet dhe sugjerimet se ku duhet vepruar e çka duhet ndryshuar, gjithnjë me qëllim të përmirësimit të performancës dhe ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët. Konsideroj se ky raport është i vonuar, pasi që tashmë jemi në përfundim të muajit maj. Këtij raporti i mungojnë të dhënrat elementare mbi të cilat do të mund ta vlerësonim. Ky nuk mund të cilësohet raport, por fatkeqësisht është një informatë e përgjysmuar, e cila nuk ofron as bazën minimale për debat në këtë Kuvend dhe shtron nevojën që menjëherë të plotësohet me të gjitha të dhënrat e nevojshme që duhet t'i prezantohen Kuvendit dhe që ne të kemi mundësi t'i nxjerrim konkluzionet e sakta. Ne kërkojmë që sa më shpejt të plotësohet ky raport me të gjitha të dhëna dhe terma të sakta. **Sami Salihu** tha se ky nuk është raport, por është informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve, dhe nuk është një raport i detajuar, andaj ne jemi kujdesur që ta bëjmë thjesht një raport të tillë.

**Granit Geci**, konsideroi se nuk është etike dhe aspak në rregull që po i lëni hapësirat e Pallatit të Rinisë për të shkuar në hapësirat e një biznesmeni, i cili është i afërt me LDK-në, kështu pres një përgjigje prej aksionarëve edhe prej kryetarit, nëse veç është informuar. **Sami Salihu** tha se ka më se 7 apo 8 muaj që ndërmarrja është në kërkim të hapësirave të reja, pa dyshim që ka me i liruar ato hapësira, jo nga dëshira por nga imponimi.

**Nora Kelmendi** theksoi se po të shikohen më në detale këto raporte dhe këto paragrafe të cilët i keni të vendosura në raporte, shihet që përpiluesit e këtij rapporti me të vërtetë duhet të ndihen keq. Ky raport lirisht mund të thuhet se është punuar dhe mund të punohet nga cilido ne të cilët as nuk jemi në komision të aksionarëve. Nëse e lexojmë këtë raport, shihet se nuk ka informacion të detajuara financiar e që është me interes për qytetarët. Duke u bazuar në këto informacione, shihet që niveli i transparencës në këtë ndërmarrje është zero, mungesa e informacionit kyçë dhe dokumentacionit financiar e vështirëson punën tonë si asamblistë në këtë Kuvend. Komisioni i aksionarëve që është caktuar nga ky Kuvend, duhet të jetë më aktiv në paraqitjen e raporteve të detajuara para qytetarëve. I bëj thirrje komisionit që në mbledhjet e radhës, të sjellë reportin për vitin 2023, po ashtu të sillet edhe rapporti për 3 mujorin e parë dhe 6 mujorin e këtij viti, në të cilin do t'i përshkruani të gjitha veprimet e marra, rezultatet financiare dhe të arritura e kësaj ndërmarrjeje.

**Triera Kasumi - Berisha**, kërkoi të dijë se në rast se ndërmarrja hyn në ndonjë detyrim nga ndonjë operator ekonomik dhe nëse ky operator e dërgon në përbirim, si planifikoni me i mbuluar detyrimet e grumbulluara. Po ashtu, një shqetësim nga terreni është shpërndarja e disa stikerave nëpër vetura të ndryshme të identifikuashme gjithandje, dhe kërkoi të dij se cilat jan kriteret për shpërndarjen e tyre. Po ashtu, ceku se a është ende aktive kontrata prej 750 mijë euro për softweri-n e ri, çka është duke ndodhur me të?

**Muhamet Selmani** tha se “Prishtina Parking” për vitin 2023 ka pasur të hyra 3.1 milion euro, nga kategoria e të hyrave është 1.4 milion euro, nga laurat, 694 mijë euro, nga parkingjet e hapura jan 722 mijë euro dhe nga intervenimet e policisë që janë bllokadë dhe gjëra tjera, ku në total kanë qenë 2 milion e 556 mijë euro. Kërkoj të dijë se prej nga kanë ardhur këto 544 mijë euro tjera. Po ashtu, kërkoj të dijë se sa është numri total i parkingjeve të hapura dhe për parkingje me laura, dhe lidhur me këtë kërkoj që parkingjet me laura mos të bllokohen, por të aktivizohen ato.

**Berna Saracı** tha se grupi për studime juridike dhe politike e ka dorzuar një kërkesë të Kuvendi komunal për rishqyrtimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, pasi që janë gjetur mangësi të cilat edhe e vënë në pikëpyetje ligjshmërinë e vetë rregullores. Lidhur me këtë kërkoj të dijë se cili është qëndrimi i ekzekutivit apo i ndërmarrjes dhe a është ndërmarrë ndonjë veprim për këtë çështje.

**Gëzim Sveçla**, ngriti shqetësim rreth menaxhimit të kësaj ndërmarrjeje, i cili tha se në “Prishtina Parking” është një bord i politizuar, që përbëhet nga ish-anëtarë ose nga anëtarë aktualë të subjektit të cilin edhe ju e përfaqësoni. Lidhur me këtë situatë të krijuar në këtë ndërmarrje, kërkoj të dijë se a ka punësime partiake dhe familjare, a ka të punësuar kandidatë për asamble nga subjekti i LDK-së, që nuk janë bërë asamblistë, si dhe a ka të punësuar familjarë të asamblistëve aktual. Po ashtu, kërkoj të dijë se a është në dijeni menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje se ekzistojnë “screen-shot”, ku punëtorët e “Prishtina Parking” udhëzohen që të dënojnë sa më shumë qytetarë nëpër lagje të ndryshme, me qëllim të arritjes së normës etj.

**Hafiz Krasniqi** tha se e inkurajojmë kryetarin bashkë me ekzekutivin, që edhe ndërmarrjet tjera të cilat veç kanë filluar të marrin të mbarën, siç e kemi edhe ndërmarrjen “Pastrimi”, apo ndërmarrjen “Gjelbër”, kështu që nëse arrijmë ta krijojmë një disiplinë financiare edhe organizative, besoj që Prishtina sa i përket ndërmarrjeve apo menaxhimit të kompanive publike jemi në trendin e duhur. Sa i përket performancësa së të hyrave në këtë ndërmarrje, mendoj se ishte jashtëzakonisht e mirë dhe për këtë do të ishte mirë që kjo po na bëhet praktikë dhe për këtë kisha kërkuar që të bëhet krahësimi edhe me planin e biznesit.

**Leutrim Retkoceri** tha se ky material nuk i ngjan një raporti, por është vetëm një fletë informuese, kështu që po ta krahsojmë me raporte, e kur ne kemi qenë anëtarë të komisionit të aksionarëpve, këto raporte kan qenë me më se 30 faqe. Në informatat që janë paraqitur, nuk jan paraqitur të gjitha shpenzimet, bëhet fjalë për shpenzimet e reprezentacionit të menaxhmentit që shkojnë rreth 20 mijë euro, kështu që konsideroj se kjo shumë e mjeteve të hargjuara është e pajustifikueshme.

**Petrif Reçica** kërkoi një arsyetim rreth mjeteve të shpenzuara për udhëtimet zyrtare jasht vendit.

**Faton Zeka**, ngriti shqetësim rreth pagësës te parkingjet me laurë, i cili tha se të faturohet

edhe një orë më tepër, veç se ka hyrë në orën e dytë për 2 sekonda, konsideroj se është e tepërt.

Lidhur me pyetjet dhe çështjt e ngritura nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhan Përparim Rama, kryetar dhe Sami Salihu, në cilësinë e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes "Prishtina Parking".

### Pika e gjashtë

#### Pyetje dhe përgjigje.

##### Petrit Reçica, për kryetarin e Komunës:

- Eshtë shqetësim i banorëve për zérin e pakontrolluar që vjen nga muzika prej lokaleve të gastronomisë, andaj kerkoj që kjo çështje të merret parsysh dhe të bëhet një zgjidhje që mos të shqetësohen banorët nga kjo dukuri.
- Punëtorët e ndërmarrjes "Sport Marketing" jan duke qëndruar në zyra te Pallati i Rinisë nga muaji janar pa pasur kontratë dhe çka do të bëhet me ata punëtorë, ku do të sistemohen me zyra.

Lidhur me pyetjet e paraqitura nga z. Reçica, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

##### Feim Osmanin, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Pse është ndërprerë projekti rrith ndërtimit të kanalizimit në fshatrat Sharban dhe Rimanishtë, dhe është tejet shqetësuese lënia në gjysmë e këtij projekti dhe bëhet derdhja e ujërave të zeza në natyrë në mesë të fshatit Besi dhe Rimanishtë.
- Po ashtu, edhe në seancën e kaluar e kam ngrit si shqetësim ndërprerjen e kontratës për rregullimin e rrugicave në fshatin Vranidoll dhe për kët pyetje nuk kam marrë asnjë informacion.

Lidhur me pye tjet e parashtruara nga z. Osman, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

##### Gëzim Sfeçla, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe për nënkyetaren e Komunës:

- Në lagjen "Pepaj" të fshatit Busi është një rrugë me gjatësi afér 1 km në gjendje të tmerrshme, e që sidomos rëndohet kjo gjendje gjatë kohës së shirave ose reshjeve të tjera atmosferike. Kerkoi që ndërrimi i saj të bëhet me prioritet.
- Pse po lëshohen leje për ndërtim të përkohshëm, kur e dijm se këto leje e kanë si bazë ligjore Rregulloren për trajtimin e ndërtimeve të përkohshme për të cilën ne e kemi shfuqizuar në këtë Kuvend.
- Disa veprime që jan ndërmarrë në kabinet, si krijimi i disa drejtorive të reja, konsideroj se është marrë një vendim i paligjshëm, që do të thot se është në kundërshtim me ligjin dhe me aktin më të lartë të Komunës që është Statuti.
- Kerkoi nga nënkyetarja e Komunës që, në momentin kur ne anëtarët e Kuvendit i

- parashtrojmë pyetjet tona lidhur me çështje të ndryshme, të jeni më të informuar
- për rastet e ndodhura, pasi që përgjigjet po jepen në mënyrë konfuze dhe konkretisht është rasti i ndërtimit të një objekti në lagjen "Arbëria".
- Për shkak të një reforme të cilën jeni në proces ta bëni me shkollën "Xhevdet Doda", për dislokimin e saj diku tjetër e në këtë objekt të jetë shkolla me mësimin qëndrim tërë ditor, mendoj se për këtë proces duhet pasur shumë kujdes, sepse ndikon në shumë aspekte të jetës.

Për pyetjet e parashtruara nga z. Sveçla, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar, Arbër Sadiku, drejtor dhe Jehona Lushaku, nënkyetare e Komunës.

#### **Ermal Osmani, për kryetarin e Komunës:**

- Prej Xhamisë së Llapit deri afér Komunës së Prishtinës, kam pritur shumë që të transformohet ajo pjesë, do të zgjerohet trotuari, do të largohen pengesat e shumta të llojeve të ndryshme që pengojnë në lëvizjen e lirë të qytetarëve. Kërkoi që kjo çështje të merret parasysh dhe të rregullohet trotuari, e në veçanti të shihet mundësia për rregullimin e një shiriti të veçantë për personat me aftësi të kufizuar.
- Po ashtu kërkoj që këndet e lojrave përfëmijë, platoja e këtyre këndëve të shtrohet me shtresa prej gome, pasi që shtresa aktuale prej guralecëve është e rrezikshme për shëndetin e fëmijëve. Kërkoj që të intervenohet më cilësinë e këtyre këndeve të lodrave dhe specifikisht këndet e lodrave në Bregun e Diellit, këndi i lojërave te Banesat e Hirta, përballë Royall Mallit, këndi i lojrave afér shkollës "Ismail Qemali", si dhe në vende tjera.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Osmani, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

#### **Besart Krasniqi, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtoris së Shërbimeve Publike:**

- Para 3 ditëve kam dorëzuar një kërkesë me petition prej 217 nënshkrimeve për ndriçimin e rrugëve "Mic Sokoli", "Destan Bajraktari" dhe "Nuhi Berisha" në lagjen "Kodra e Trimave", rrugë afér shkollës fillore "Zenal Hajdini", ku banorët kërkojnë që sa më shpejtë të bëhet ndriçimi i këtyre rrugëve.
- Eshtë kërkesë e banorëve të fshatrave të Gollakut, si fshati Llukar, Grashticë, Makovc që nuk kan linjë të rregullt të autobusëve, ditëve të punës e kanë deri në 20:00 në mbrëmje, kurse të vikendit deri në ora 17:00.
- Pse ka ndërruar linja e autobusit Prishtinë - Fushë Kosovë, ku deri para një kohe kjo linjë ka përshkruar rrugën kah Komuna e Prishtinës dhe ka vazhduar tutje?
- Banorët e fshatit Koliq kanë kërkuar që të bëhet rregullimi i rrugës "Sefa Selimi".
- Shitësit ambulantë ankohen për çmimin prej 310 euro për qiranë mujore, ku ata kanë konsideruar se ky çmin është shum i lartë. Po ashtu, disa ankohen që me vite të tëra, prej vitit 2008 kanë punuar në rrugën "Regjep Luci" dhe jan larguar nga ajo rrugë, iu ka ndryshuar destinacioni, dhe këtë veprim e konsiderojnë si të padrejtë.

Lidhur me pyetjet e prashtruara nga z. Krasniqi, përgjigje dhan Përparim Rama, kryetar dhe Bekim Brestovci, drejtor.

**Arbnora Berisha, për kryetarin e Komunës:**

- Banorët e fshatit Barilevë kërkojnë të dijnë arsyen, pse pas përfundimit të ndërtimit të urës nuk është rindërtuar rruga që është dëmtuar nga ndërtimi i urës së re, pasi ura ka mbetur në nivel shumë të lartë me krahasim me nivelin e rrugës aktuale dhe po shkakton probleme tek banorët dhe lëvizjet e tyre me vetura.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Berisha, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

**Sami Salihu, për kryetarin e Komunës:**

- Si banor i lagjes "Dardania", jemi të shqetësuar për uzurpimin e pronave publike, kryesisht për hapësirat gjelbëruese, ku disa persona kanë vendosur rrethoja dhe i pamundësohet ndërmarrjes "Gjelbër" që të bëjnë mirëmbajtjen e tyre. Kërkoj që për këtë çështje të merret ndonjë veprim në sanimin e saj.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:00.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Fehmi Kupina**



Faqe 11 nga 11